



Vlaanderen  
is divers



# Mirë se erdhe në Flandër

Në këtë broshurë të jepen përgjigjet e  
pyetjeve të tua të para në Belgjikë

# Mirë se erdhe në Flandër

Ka pak kohë që ti banon në Flandër. Ndoshta është gjithçka e re për ty, apo ndoshta ti i di disa gjëra. “*Ku mund të mësoj unë holandisht? Si të gjej unë punë?*” Në këtë broshurë të jepen përgjigjet e pyetjeve të tua të para në Belgjikë. Informacionet i gjen të ndara në tema.



## Të ndihesh në Flandër si në shtëpinë tënde

Çfarë mëson ti gjatë një trajekti të integritit? faqja 5



## Mësimi i holandishtes

Si mund të regjistrohesh në mësimet e holandishtes? faqja 6



## Komuna/bashkia jote

Për çfarë mund të drejtohesh tek komuna/bashkia jote? faqja 9



## Puna dhe trajnimet/kurset

Si mund të gesh ti punë apo një trajnim/kurs? faqja 10



## Fëmijët

Si funksionon arsimi në Belgjikë? Dhe kush mund të të ndihmojë për pyetjet mbi edukimin? faqja 12



## Banesa

Si mund të kërkosh ti një banesë? faqja 15



## Financat

Si mund të hapësh një llogari bankare?  
Çfarë bën ti në rast problemesh financiarë? faqja 16



## Shëndeti dhe mirëqënia

Çfarë duhet të bësh ti nëse je i/e sëmurë? faqja 18



## Transporti/udhëtimi

A mund t'ia arrish që të njihet leja jote e drejtimit/patentë shoferi jote e huaj/jo belge? faqja 20



Dëshiron t'a lexosh këtë broshurë në një gjuhë tjetër?  
Kërko në internet në [welkom.inburgering.be](http://welkom.inburgering.be)





## Dëshiron të dish më tepër mbi këto tema dhe mbi jetesën në Belgjikë?

Ti mund të ndjekësh një **trajekt integrimi** në një nga Agjencitë/zyrat e integritimit. Trajekti të ndihmon për t'u ndjerë më shpejt si në shtëpinë tënde. Për shembull, ti ndjek një kurs mbi jetesën në Flandër dhe Belgjikë dhe të jepet udhëzim në gjuhën tënde, ose në një gjuhë që e flet mirë. Informacione të mëtejshëm gjen në faqen 5 të kësaj broshure.

## Dëshiron të dish më tepër? Atëherë merr një takim tek Agjencia afër teje.

Agjencitë të mbështesin në fillimin e jetës tënde të re në Flandër. Informacione të mëtejshëm gjen në faqen 4 të kësaj broshure.

 Informacione të Mëtejshme mbi jetesën në Belgjikë: [www.fedasilinfo.be](http://www.fedasilinfo.be)



# Dëshiron informacione të Mëtejshme mbi trajektin e integritit?



**Amal**

## Banon ti në Gent?

Merr një takim tek Amal  
[www.amal.gent/contact](http://www.amal.gent/contact)



**atlas**

## Banon ti në Antwerpen?

Merr një takim tek Atlas  
[www.atlas-antwerpen.be/nl/contact](http://www.atlas-antwerpen.be/nl/contact)



**Bon**

## Banon ti në Bruksel?

Merr një takim tek Bon  
[www.bon.be/contact](http://www.bon.be/contact)



**AGENTSCHAP  
INTEGRATIE &  
INBURGERING**

## Banon ti në një vend tjetër në Flandër?

Merr një takim tek Agentschap Integratie  
en Inburgering – Agjencia e Integritit (AgII)  
[www.integratie-inburgering.be/  
contactpunten](http://www.integratie-inburgering.be/contactpunten)





## Të ndihesh në Flandër si në shtëpinë tënde

Je i ri në Flandër. **Trajekti i integrit** të ndihmon të orientohesh në një vend të ri. Kështu ti mund të ndihesh më shpejt si në shtëpinë tënde.

- Në mësimet e orientimit në shoqëri ti mëson mbi jetesën në Belgjikë. Ti i ndjek mësimet në gjuhën tënde, ose në një gjuhë që e kupton mirë.
- Ti kërkon bashkë me ne një kurs të holandishtes që të përshtatet. Të jepen gjithashtu këshilla për të ushtruar holandishten.
- Kërkon punë? Apo dëshiron të studiosh? Ne dëgjojmë synimet e tu. Ti regjistrohesh në VDAB dhe ti mbështetesh për të gjetur punë ose një trajnim/kurs.
- Ti takon njerëz të rinj dhe ti merr pjesë në aktivitete sociale gjatë trajektit të pjesëmarrjes në shoqëri.

Gjatë trajektit tënd të jepet udhëzim individual dhe informacione në gjuhën tënde, ose në një gjuhë që ti e kupton mirë. Një udhëzues i trajektit të udhëzon gjatë gjithë trajektit tënd.



[www.inburgering.be](http://www.inburgering.be)





## Mësimi i holandishtes

### Dëshiron të mësosh holandisht?

Holandishtja është e rëndësishme për t'u ndjerë në Flandër si në shtëpinë tënde. Merr një takim tek Agll, Amal ose Atlas. Një punonjës shikon bashkë me ty se cili kurs të nevojitet.



Informacione të mëtejshme:



### Si mund të ushtrosh holandishten?

Tek [www.ikdoemee.be](http://www.ikdoemee.be) ti gjen aktivitete afër teje.



### Disa fjalë holandisht

- |                                 |                                       |
|---------------------------------|---------------------------------------|
| • Unë jam ...                   | <i>Ik ben ...</i>                     |
| • Unë banoj në ...              | <i>Ik woon in ...</i>                 |
| • Unë flas ...                  | <i>Ik spreek ...</i>                  |
| • Të lutem                      | <i>Alsjeblieft</i>                    |
| • Faleminderit                  | <i>Dank u wel</i>                     |
| • S'ka përse                    | <i>Graag gedaan</i>                   |
| • Mirëmëngjesi (ora 6:00-12:00) | <i>Goedemorgen (06.00 tot 12.00u)</i> |
| • Mirëdita (ora 12:00-18:00)    | <i>Goedemiddag (12.00 tot 18.00u)</i> |
| • Mirëmbrëma (ora 18:00-24:00)  | <i>Goedenavond (18.00 tot 24.00u)</i> |
| • Mirupafshim (kur ndahesh)     | <i>Tot ziens/ Dag (voor afscheid)</i> |



## E dije ti që në Flandër duhet të dish të flasësh holandisht

- për të punuar (në një shkollë, në një çerdhe, tek një administratë qeveritare ...)?
- për të marrë me qira një banesë sociale?
- për të kërkuar shtetësinë belge?



*“Trajekti i integritit nuk ishte i detyrueshëm për mua, por mua m’u duk i rëndësishëm. Unë dëshiroja të njihesha me kulturën dhe rregullat në Belgjikë.”*

ROZA





*“ Unë u regjistrova tek VDAB. Ata gjetën shumë shpejt një punë për mua tek një bukëpjekës.”*

RAMAZAN





## Komuna/bashkia jote

### Zyrat e komunës/bashkisë

Ti duhet të regjistrohesh tek bashkia apo tek komuna ku banon. Këtë e bën tek zyrat e komunës/bashkisë. Çdo komunë/bashki ka zyra të komunës/bashkisë. Në zyrat e komunës/bashkisë mund të të jepen dokumentet zyrtarë: dokumentet/leja e qëndrimit, të bësh regjistrimin në komunë/bashki, të bësh ndryshimin e adresës tënde, provën e lindjes, leje drejtimi/patentë shoferi ...

Dokumentet e tu të qëndrimit duhet të jenë në rregull. Në shumë situata të nevojitet një provë identiteti e vlefshme. Për shembull: për të marrë me qira një shtëpi, për të punuar, për të shkuar tek mjeku, për të filluar një trajekt integrimi ...

Tek zyrat e komunës/bashkisë të jepen gjithashtu informacione mbi kohën e lirë, sportin, bibliotekën ... Për informacione të mëtejshme shiko tek faqja në internet e komunës/bashkisë tënde!



### Ke probleme financiarë apo të tjerë? Ke nevojë për udhëzim social?

Shko tek het Sociaal Huis (OCMW - Qendra Publike për Mirëqënien e Shoqërisë) të komunës/bashkisë tënde. Shërbimi social shikon bashkë me ty se si ata mund të të ndihmojnë.



Informacione të mëtejshme:





# Puna dhe trajnimet/ kurset

## Si mund të gjesh punë?

Nuk ke akoma një punë? VDAB-ja ose OCMW-ja (nëse ti merr asistencë financiare) të udhëzon për të kërkuar punë. Regjistrohu si kërkues pune tek VDAB-ja! Kjo mund të bëhet me anë të internetit, ose tek një zyrë e VDAB-së. Një pasqyrë e gjen tek [www.vdab.be/contact](http://www.vdab.be/contact).



☎ 0800 30 700

🌐 Regjistrohu me anë të internetit në: [www.vdab.be/inschrijven](http://www.vdab.be/inschrijven)

⚠ **Silli me vete dokumentet/lejen e qëndrimit!**

Këta dokumente të nevojiten për të punuar në Belgjikë.

💡 **KËSHILLË** | Informacione të mëtejshme mbi të drejtat e tua si punëmarrës:

🌐 [www.fairworkbelgium.be/workers/your-rights/](http://www.fairworkbelgium.be/workers/your-rights/)

Gjatë trajektit të integrimit ti mëson se si mund të kërkosh punë, si mund të përgatitesh për një intervistë pune dhe të jepen këshilla për një CV të mirë. Dëshiron të punosh si i pavarur/i vetëpunësuar? Apo pyet veten se cilat janë të drejtat e tua në rast se pushohesh/hiqesh nga puna? Edhe këtë e mëson gjatë mësimëve mbi jetesën në Belgjikë (Shiko faqen 5).



## **E NDJEK TRAJEKTIN E INTEGRIMIT?**

Ti je i/e detyruar që brenda dy muajsh të regjistrohesh tek VDAB-ja (nëse ti nuk e ke bërë këtë akoma).





## Studime

### Ku në Flandër mund të studiosh ti si i rritur?

- Ti mund të ndjekësh një trajnim/kurs tek një Centrum voor Volwassenenonderwijs (CVO) Qendër për Arsimitin e të Rriturve.
- Ti mund të ndjekësh një trajnim/kurs tek Ligo, Centrum voor Basiseducatie Qendër për Edukimin Bazë.
- Ti mund të ndjekësh arsim të lartë në një shkollë të lartë apo universitet.  
Çfarë të nevojitet?
  - një diplomë e arsimit të mesëm
  - disa universitete dhe shkolla të larta kërkojnë të bëhet një test i nivelit tënd të holandishtes. Një shembull i një testi të tillë është ITNA: [www.itna.be](http://www.itna.be).

 Informacione të mëtejshme: [www.volwassenenonderwijs.be](http://www.volwassenenonderwijs.be)


 Një pasqyrë e ofertës/programeve: [www.opleidingskompas.be](http://www.opleidingskompas.be)



### Njësimi/njohja e diplomës

Ke një diplomë nga një shtet tjetër përveç Belgjikës? Ti mund t'a njësosh/njohësh diplomën tënde në Flandër tek NARIC-Vlaanderen (National Academic Recognition Information Centre). Procedura për njësimin/njohjen është e ndërlikuar.

Ndjek një trajekt integrimi? AgII, Amal ose Atlas të udhëzojnë në procedurë. Një diplomë e njësuar/njohur të jep më tepër mundësi për të gjetur një punë, apo për të studiuar më tej..

 Informacione të mëtejshme: [www.naricvlaanderen.be](http://www.naricvlaanderen.be)





## Fëmijët

Kind en Gezin (Fëmija dhe Familja), që bën pjesë e Agentschap Opgroeien (Agjencia e Rritjes së fëmijëve), të ndihmon në rast pyetjesh mbi



- ruajtjen e fëmijëve (çerdhe)
- edukimin
- shtatëzaninë dhe lindjen
- ...

 Informacione të mëtejshme: [www.kindengezin.be](http://www.kindengezin.be)

 078 150 100

### Shkollë për fëmijën tënd

Në Belgjikë gjithë fëmijët nga 5 deri 18 vjeç kanë detyrimin për arsimim. Detyrimi për arsimim fillon më 1 shtator të vitit kur fëmija jote mbush 5 vjeç. Nga ai moment fëmija jote duhet të ndjekë arsim. Shumica e fëmijëve e fillojnë shkollën (kopshtin) nga mosha 2,5 deri 3 vjeç. Ti e zgjedh vetë një shkollë.

| Kopshti         | Arsimi bazë    | Arsimi i mesëm  | Arsimi i lartë |
|-----------------|----------------|-----------------|----------------|
| 2,5 deri 6 vjeç | 6 deri 12 vjeç | 12 deri 18 vjeç | nga 18 vjeç    |



Sistemi i arsimit të shpjegohet krejtësisht në mësimet mbi jetesën në Belgjikë. Ke nevojë për ndihmë për të gjetur një shkollë për fëmijën tënd? Merr një takim tek një Agjenci Integrimi Agentschap voor Integratie en Inburgering (Shiko faqen 4).

 Informacione të mëtejshme:



## Groeipakket (Paketa e Rritjes)

Në Flandër të jepet çdo muaj një mbështetje financiare për edukimin e fëmijës tënd/ fëmijëve të tu. Kjo është het Groeipakket. Shuma varet nga situata jote personale.

 Informacione të mëtejshme: [www.groeipakket.be](http://www.groeipakket.be)

“ Djali im shkon në shkollë. Pra mësimi i holandishtes është i rëndësishëm për mua. Kështu unë mund të flas më mirë me mësuesit e tij dhe unë mund të kuptoj se çfarë bisedon ai me shokët e tij.”

MERVE





*“ Unë ndihesha i/e vetmuar. Por gjatë trajektit tim të integrimit unë u njoha me gra të tjera. Ato janë akoma shoqe të mija. Në një vend të ri, shokët/shoqet e tua të bëhen familja jote. “*

LAURA






# Banesa

## Si e gjen ti një banesë ?

Gjatë trajektit të integritimit (Shiko faqen 5) të jepen informacione mbi:

- se cilat organizata mund të të ndihmojnë
- kontratat e qirasë
- se çfarë duhet të bësh nëse ti dëshiron të blesh një banesë
- se si mund të përgatitesh për të vizituar një banesë
- ...


 Informacione të mëtejshme mbi se si mund të kërkosh një banesë dhe se ku duhet të bësh kujdes: [www.fedasilinfo.be/nl/zoektocht-naar-een-woning](http://www.fedasilinfo.be/nl/zoektocht-naar-een-woning)




## Woonmaatschappij (Shoqëria e banesave)

Nuk është e mundur financiarisht për ty për të marrë me qira një apartament apo një shtëpi? Ti mund të marrësh me qira një banesë sociale. Në atë rast ti paguan një çmim më të ulët për qiranë. Për një banesë sociale ka kushte të veçantë. Një shoqëri e banesave kontrollon situatën tënde.

Ke të drejtë për një banesë sociale? Së pari të vendosin në një listë pritjeje.

 Informacione të mëtejshme mbi banesat sociale:



 Gjej një shoqëri të banesave afër teje:



## KËSHILLË

**Banon ti në Gent?**  
Kontakto woonwyzers (treguesit e banesave):



**Banon ti në Antwerpen?**  
Kontakto një woonkantoor (zyrë banesash):



Shiko pak nëse komuna/bashkia ku ti dëshiron të banosh ka një woonwinkel (dyqan banesash):





# Financat

## Pagesat

Kudo në Belgjikë mund të paguash me para në dorë, ose me një kartë të bankës.

**A e dije se ... gjithësecili në Flandër ka të drejtë të ketë një numër llogarie bankare të thjeshtë/bazë me kartë të bankës?**

**Kështu ti mund të:**

- paguash në mënyrë elektronike në dyqane;
- tërheqësh dhe të derdhësh para në Belgjikë;
- bësh transferta parash nga llogaria;
- kërkosh pasqyrat e ndryshimeve në llogarinë tënde



### **⚠ BËJ KUJDES:**

- Me një numër llogarie bankare të thjeshtë/bazë ti nuk mund të bësh pagesë të shtyrë më vonë.
- Me një numër llogarie bankare të thjeshtë/bazë ti nuk mund të marrësh kredi.
- Është gjendja jote 0 € ? Atëherë ti nuk mund të bësh më pagesa.

## **Dëshiron të hapësh një llogari bankare në Flandër?**

Ti e zgjedh vetë se në cilën bankë në Flandër e hap një llogari të parë. Ti zgjedh një llogarie bankare të thjeshtë/bazë, ose një llogari të zakonshme.







### Çfarë të nevojitet për të hapur një llogari bankare?

- karta jote elektronike e identitetit ose dokumenti yt i (leja jote e) qëndrimit. Ti duhet të provosh identitetin tënd.
- një letër të komunës/bashkisë tënde për të shkuar për të marrë kartën e identitetit, ose dokumentin/lejen e qëndrimit, ose një vërtetim nga komuna/bashkia. Ti duhet të provosh adresën tënde.

### Ke probleme financiare?

Ti mund të drejtohesh tek Sociaal Huis (OCMW) e komunës/bashkisë tënde për mbështetje financiare. Ti mund të kërkosh asistencë financiare (leefloon) në momentet kur ti përkohësisht nuk ke të ardhura, apo ke të ardhura të kufizuara. Asistenca financiare (leefloon) është një ndihmë financiare e përmuajshme. Ata mund të të mbështesin edhe për shembull për shpenzimet e larta për energjinë, shpenzimet e shkollës ...

### A mund të marrë gjithësecili me probleme financiarë një asistencë financiare (leefloon)?

Jo. Ti duhet të përmbushësh kushte të veçanta. Ti bën një kërkesë tek Sociaal Huis ose OCMW-ja. Ata shqyrtojnë nëse ti mund të marrësh asistencë financiare (leefloon).

 Informacione të mëtejshme: [www.vlaanderen.be/leefloon](http://www.vlaanderen.be/leefloon)





# Shëndeti dhe mirëqënia

## Je i/e sëmurë?

Shko tek mjeku i familjes! Mjeku i familjes (ose doktori i familjes):

- është personi yt i parë për të kontaktuar për pyetjet e tua mjekësore;
- administron dosjen tënde mjekësore;
- të viziton;
- mund të të referojë/dërgojë tek një specialist.

 Gjej një mjek të familjes afër teje: [www.desocialekaart.be](http://www.desocialekaart.be)

## KE NEVOJË MJEKËSORE?

**1733**  
*(re)*

Ke nevojë (jo urgjente) mjekësore në fundjavë, apo në ditë festash? Telefono tek një doktor roje në numrin 1733!

**112**  
*(re)*

Ke nevojë për kujdes urgjent mjekësor? Ke një aksident? Telefono falas në numrin 112.



**KËSHILLË** | Shkarko aplikacionin 112 BE



Informacione të mëtejshme: [www.112.be/nl/mobile-applicatie](http://www.112.be/nl/mobile-applicatie)

**101**  
*(re)*

Ke nevojë vetëm për policinë? Telefono në numrin 101.

Me anë të aplikacionit ti mund të telefonosh drejtpërdrejtë zjarrfikësit, një ambulancë apo policinë. Me anë të aplikacionit, vendndodhja jote bëhet menjëherë e dukshme për punonjësit e shërbimeve të ndihmës.



## Bëj kujdes

Në Belgjikë një siguracion shëndetësor/në rast sëmundjesh është i detyrueshëm. Ky siguracion është i rëndësishëm. Siguracioni të ndihmon për të paguar shpenzimet e tu mjekësorë.

 **KËSHILLË** | Tek HZIV (Hulpkas voor Ziekte- en Invaliditeitsverzekering - Fondi i Ndhmës për Pagesat në rast Sëmundjesh apo Invaliditeti) të jepet siguracioni i detyrueshëm pa shpenzime shtesë.

 Informacione të mëtejshme: [www.caami-hziv.fgov.be/nl/leden/](http://www.caami-hziv.fgov.be/nl/leden/)

Cili është ndryshimi ndërmjet siguracionit shëndetësor/në rast sëmundjesh dhe siguracionit për shtrimin në spital? Dhe cilat janë të drejtat e mija si pacient? Këto i mëson gjatë trajektit të integritit (Shiko faqen 5).



## Mirëqënia

### Ke nevojë për ndihmë psikologjike?

Kontakto Centrum Algemeen Welzijnswerk (CAW) Qendrën për Mirëqënie e Përgjithshme!

 0800 13 500

 [www.caw.be](http://www.caw.be)

### Ke qenë viktimë e diskriminimit?

 Kontakto Unia me anë të numrit falas 0800 12 800.

### Ke pyetje mbi dhunën, abuzimin/keqtrajtimin dhe keqtrajtimin e fëmijëve?

Kontakto 1712!

 1712

 [www.1712.be/nl](http://www.1712.be/nl)





## Transporti/udhëtimi

### Transporti publik

Në Flandër mund të marrësh trenin, tramvajin dhe autobusin për t'u zhvendosur/udhëtuar. Blej një biletë gjithmonë para se të hipësh! Është e detyrueshme të aktivizosh biletën. Skanoje biletën tënde çdo herë kur hipën në një tramvaj apo autobus! Nëse ti nuk ke një biletë të vlefshme, të vihet gjobë.

Ku e blen biletën? Ti mund t'a blesh biletën tënde tek një sportel në stacion, me anë të një automati, ose me anë të celularit tënd. Në tramvaj dhe në autobus ti mund të paguash edhe me kartën tënde të bankës.



Më shumë informacion rreth autobusit dhe tramvajit:



[www.delijn.be](http://www.delijn.be)



Më shumë informacion rreth trenit:



[www.nmbs.be](http://www.nmbs.be)

### Karta MoBIB

Karta MoBIB është një kartë për abonimet apo biletat e të gjithë transporteve publikë në Belgjikë.

Informacione të mëtejshme: [www.mobib.be](http://www.mobib.be)





*“Unë nuk njihja askënd. Detyra ime e parë ishte të mësoja gjuhën. Këtë e bëra duke bërë punë vullnetare, duke huazuar një libër, apo duke dëgjuar podcasts (emisione zanore).”*

HAKAN





# Leje drejtimi/ patentë shoferi

Ti duhet të kesh një leje drejtimi/patentë shoferi të vlefshme belge apo ndërkombëtare për të ecur/voztur me makinë në Belgjikë. Ke një leje drejtimi/patentë shoferi të vlefshme të një shteti europian? Me këtë ti mund të ecësh/voztësh me makinë në Belgjikë. Ti nuk duhet t'a ndërrosh atë në leje drejtimi/patentë shoferi belge (për sa kohë është e vlefshme).

Ke një leje drejtimi/patentë shoferi nga një vend jashtë Bashkimit Europian? Me të ti lejohesh të ecësh/voztësh me makinë në Belgjikë vetëm për 185 ditë. Pastaj me këtë leje drejtimi/patentë shoferi ti mund të kërkoh një leje drejtimi/patentë shoferi belge.

**⚠ BËJ KUJDES:** Jo të gjitha lejet e drejtimit/patentat e shoferit të japin të drejtë për të marrë një leje drejtimi/patentë shoferi belge. Këtu gjen listën me shtetet jashtë Bashkimit Europian të njohur:




## Ku mund të kërkoh një leje drejtimi/patentë shoferi belge?

Një leje drejtimi/patentë shoferi belge mund t'a kërkoh tek zyrat e komunës/bashkisë (Shiko faqen 9). Procedura zgjat disa javë apo muaj. The procedure takes several weeks or months.

## Nuk ke akoma leje drejtimi/patentë shoferi?

Ti duhet të bësh një provim për të ecur/voztur me makinë.

 Informacione të mëtejshme:



## Cilat janë rregullat e qarkullimit? Si është mënyra më e mirë të zhvendosem/udhëtoj? Apo si e planifikoj unë trajektin tim/udhën time?

Këtyre pyetjeve i përgjigjemi në mësimet mbi jetesën në Belgjikë gjatë një trajekti të integritimit (Shiko faqen 5).




*“Unë ia këshilloj trajektin e integritit të gjithë të sapoardhurve. Kjo është mënyra më e mirë për t'u integruar.”*

FATOU



# Mirë se erdhe në Flandër



## E dije ti këtë tashmë?



**Brukseli është kryeqyteti** i Belgjikës. Belgjika ka 3 rajone: Flandri, Valonia dhe Brukseli.



Në Belgjikë paguan kudo me **euro**.



Gjuhët zyrtare në Belgjikë janë **holandisht, frëngjisht** dhe **gjermanisht**.



Belgjika është një **mbretëri**. Kryetari i shtetit është **mbreti Filip**. Gruaja e tij është mbretëresha Mathilde.



Belgjika është një **demokraci**. Njerëzit në Belgjikë lejohen që edhe ata të vendosin për politikën.



Në Belgjikë ka **liri të besimit fetar**. Ti e zgjedh vetë nëse ti beson. Ti e zgjedh vetë besimin fetar tënd.





*“Në fillim të mungojnë familjarët dhe shokët/  
shoqet. Prandaj të nevojitet një rrjet shoqëror.  
Ke nevojë për dikë me të cilin/cilën mund të  
flasësh nëse ke një problem, nëse je i/e gëzuar  
apo i/e trishtuar. Ke nevojë për shokë/shoqe.”*

VONNY & ANDREEA



